



C.nr.546/17

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe bashkëpunëtorin profesional Fatlum Halimi, në çështjen e inicuar me padinë e paditëses [REDACTED] nga Shtimja, Rr.”[REDACTED] kundër të paditures [REDACTED] – [REDACTED] për shkak të kompensimit të tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilare, me datë 29.09.2017, jashtë seancës ka marrë këtë:

**A K T G J Y K I M**  
*– pa shqyrtim kryesor te çështjes –*

- I. **APROVOHET** pjesërisht padia dhe kërkesëpadia e paditëses [REDACTED] nga Shtimja, Rr.”[REDACTED] e ushtruar kundër të paditures [REDACTED] – [REDACTED], për shkak të kompensimit të tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilare.
- II. **OBLIGOHET** e paditura [REDACTED] – [REDACTED] që në emër të kompensimit të tri pagave mujore dhe dy pagave jubilare t’ia paguaj paditëses shumën prej **2,277.70 €**, me kamatën e cila do të llogaritet sipas lartësisë që aplikojnë bankat vendore për deponimet e rëndomta të qytetarëve, për periudhë afatizuese një vjeçare, nga data e nxerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- III. **OBLIGOHET** e paditura t’ia kompensoj paditëses shpenzimet e procedurës gjyqësore si dhe shpenzimet e përfaqësimit për avokat sipas tarifave të përfaqësimit të përcaktuara nga OAK-së.
- IV. Nga pjesa e kërkesë padisë e cila është kërkuar nga paditësja në shumë prej **2,580.00 €**, aprovohet vetëm shuma prej **2,277.70 €**, ndërsa shuma tjeter e mbetur prej **302.30 €** **REFUZOHET SI E PA BAZUAR**.

## A r s y e t i m i

Paditësi ka ushtruar padi kundër të paditures me datën 27.06.2017, me kërkesën për kompensimin e tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilare pas daljes në pension.

Gjykata, pasi që ka shqyrtuar shkresat e lëndës, ka obliguar të padituren që t'a parashtron përgjigjen në padinë e paditësit. E paditura në përgjigjen e saj në padi, ka kundërshtuar kérkespadinë duke theksuar se pas hyrjes në fuqi të Kontrates kolektive Qeveria e Kosovës ende nuk ka nxjerrur udhëzimet administrative për zbatimin e Kontratës kolektive në rastet kur ka implikime financiare, dhe si rezultat i kësaj ne si Drejtori nuk kemi asnë udhëzim se si të veprohet me implikimet financiare të cilat rrjedhin nga Kontrata kolektive. Mëtej në përgjigjen në padi Drejtoria thekson se, sa i përket pagave përcjellëse dhe pagave jubilare, K [REDACTED] gjegjësisht [REDACTED] nuk ka paraparë buxhet dhe nuk ka një vijë buxhetore për mbulimin e kësaj kategorie, prandaj në mungesë të fondit nuk mund të bëjë pagesën e pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes kontestimore, për aq sa palët ndërgjyqëse përbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 8.1 të LPK-së, gjykata ka administruar provat si vijojnë: Shkresën zyrtare nr.05/284 e datës 04.05.2017; Vendimin nr.05/610/01/14509/17 i datës 22.05.2017; Vërtetimin nr.581 i datës 23.06.2017; Vërtetimin nr.583 i datës 23.06.2017; Vërtetimin nr.900/2 i datës 10.07.2017.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kérkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësja për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension dhe nuk është kontestuese se paditëses i takon shpërblimi i pagave përcjellëse dhe atyre jubilare.

Me leximin e Vërtetimit nr.581 të datës 23.06.2017 Gjykata ka konstatuar se paditësja ka punuar te e paditura 25 vite pa ndërprerë, dhe atë nga data 01.09.1991 deri me datë 15.02.2017 kur edhe ka dalur në pension. Me leximin e Vërtetimit nr.583 të datës 23.06.2017 Gjykata ka konstatuar se paditësja në tre muajt e fundit para pensionimit ka pranuar pagën mujore nga e paditura në shumë prej 455.54 € për çdo muaj në shumë të pandryshuar. Me leximin e Shkresës zyrtare nr.05/284 e datës 04.05.2017 Gjykata ka konstatuar se e paditura i a ka refuzuar kérkesën paditëses për shpërblimin e pagave përcjellëse dhe atyre jubilare; Me

leximin e Vendimit nr.05/610/01/14509/17 të datës 22.05.2017 Gjykata ka konstatuar se Komisioni për shqyrtimin e ankesave për sektorin e arsimit në [REDACTED] ia ka refuzuar ankesën paditëses për shpërblimin e pagave përcjellëse dhe atyre jubilare; Me leximin e Vërtetimit nr.900/2 të datës 10.07.2017 Gjykata ka konstatuar se paditësja ka qenë anëtarë e SBASHK-ut (Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkenës dhe Teknologjisë) deri në momentin e pensionimit.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë së shpërblimit të pagave përcjellëse dhe pagave jubilare, u bazua në përvojën e punës së paditësës në gjatësi prej 25 vite, e që sipas nenit 36.9 pika 7.2 e Kontratës kolektive, paditësë i takon shpërblimi vetëm në dy paga jubilare sipas lartësisë së pagës bazë në tre muajt e fundit, e që kjo shumë është 911.08 €, si dhe tri pagave përcjellëse sipas lartësisë së pagës mesatare bazë në tre muajt e fundit në shumë prej 1366 €, e që në total kap shifrën 2,277.70 € bazuar në Vërtetimin nr.581 të datës 23.06.2017 dhe Vërtetimin nr.583 të datës 23.06.2017.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësen Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në nenin 53 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 01 Janar të viti 2015 , ndërsa me nenin 51 të kësaj kontrate zbatohet në rastin kur ka implikime financiare.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të Kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësja e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që e njejtë përfiton nga kjo kontratë përfaktin se me rastin e daljes së saj në pension Kontrata kolektive ka qenë në fuqi, e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Në nenin 36 par. 9 pika 9.1 dhe 9.23 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi, i fundit në vlerë të një page bazë, për 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë dhe për 30 vite të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar, se shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditëses brenda 1 muaji sipas nenit 36 par. 9 pika 9.5 t'ia paguajë dy paga jubilare dhe tri paga

përcjellëse, pasi që i ka plotësuar këto kushte, pasi ka pasur përvojën e punës mbi 25 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë qoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Kurse neni 36 par. 10 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin konkret Gjykata ka marr parasysh që tri pagat e fundit të punëmarrëses kanë qenë të pandryshuara, secila nga 455.54 €.

Pretendimet e përfaqësuesit të të paditurës se paditëses kërkesën për kompensimin e pagave përcjellëse duhet t'ia refuzuar përfaktin se e paditura nuk ka pasur fonde të veçanta që ti përbushë këto detyrime, këto pretendime përfaktin janë të pa bazuara përfaktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë Kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin përfaktin raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara përfaktin raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësja.

Nga sa u tha më sipër, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazur në nenin 152 të LPK-së, lidhur me nenin 36 par.9 dhe par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar nr.18 e datës 11.04.2014.

Për shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në bazë të nenit 452 par.1 të LPK-së.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.546/17, me datën 29.09.2017

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA KOSOVO

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JË PRAVNO-SNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC.



Gjyqtari,  
**Enes Mehmeti**

KUSIMILLE SURDIKE; Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit tij, në gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.